V E N D I M
Nr. 627, datë 13.12.2002

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 215, DATË 16.5.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NEGOCIATOR SHQIPTAR, PËR PËRGATITJEN E NEGOCIATAVE ME KOMISIONIN EUROPIAN DHE SHTETET ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN, PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 29 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Integrimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 215, datë 16.5.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titullin e vendimit pas fjalëve "…Komisionin Europian…" të shtohen fjalët "…komunitetet europiane…".

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Anëtarët e grupit negociator shqiptar janë përgjegjës për ndjekjen dhe bashkërendimin e detyrave specifike, sektoriale, si dhe për këshillimin e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, përkatëse, për realizimin e negociatave për marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Komisionin Europian, komunitetet europiane dhe shtetet anëtare të Bashkimit Europian.".

3. Pika 5,6 dhe 7 ndryshohen si më poshtë vijon:

"5. Anëtarët e grupit negociator, si përfaqësues të institucioneve përkatëse, përgatisin raporte e dokumente standarde dhe kontribuojnë në hartimin dhe projektimin e strategjive, të planeve dhe të projekteve për procesin e integrimit europian, në bashkëpunim dhe bashkërendim me Departamentin e Integrimit, pranë Ministrit të Shtetit për Integrimin.

6. Anëtarët e grupit negociator t'i paraqesin drejtuesit të institucionit përkatës nevojat për burime, njerëzore dhe logjistike, për ndjekjen dhe plotësimin detyrave, të ngarkuara në kuadër të integrimit europian.

7. Anëtarëve të grupit negociator shqiptar t'u jepet një shpërblim deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, sipas përcaktimit të Ministrit të Shtetit për Integrimin, pasi të jetë bërë vlerësimi i veprimtarisë së tyre. Ky fond të përballohet nga buxheti vjetor, i miratuar për Këshillin e Ministrave.".

4. Pas pikës 7 shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

"8. Anëtarët e gurpit negociator emërohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Integrimin.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano